



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **26.1.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi që kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 27.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunale, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit! Kjo është mbledhja e parë e rregullt e legjislaturës 2025-2029 dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Dhënia e betimit të kuvendares znj. Florida Bajraktari dhe kuvendarit **z. Behlul Krasniqi**;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – “Park Hotel Plaza”;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokali – “Parku i qytetit”;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 01 Nr. 181/24, i datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, i datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisioneve të themeluara nga kuvendi i komunës;
11. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2025;
12. Shqyrtimi i raportit financiar janar – dhjetor 2025;
13. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

Shtesë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, 17 shtator 2025;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut, janar 2026;
3. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

Kryesuesi: Fillimisht, ju anëtarë të kuvendit, a e keni pranuar materialin me kohë dhe a keni ndonjë vërejtje lidhur me materialin, si dhe me rendin e ditës?

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Në materialin që ka ardhur në email, raporti për vlerësimin e dëmeve është vetëm për vitin 2025, kurse raportin që e keni dërguar sot, është për dëmet që janë shkaktuar më 5,6,7 janar 2026. Do të thotë ky i fundit është përfundimtar.

Kryesuesi: Realisht janë dy materiale sa u përket vërshimeve. Atëherë, e lexuam rendin e ditës. Të nderuar anëtarë të kuvendit, më lejoni që t'i lexoj edhe tre pika shtesë që sot do t'i kemi: 1. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, 17 shtator 2025. 2. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut, janar 2026. 3. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës. I vendosim në votim këto pika shtesë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, 23 vota janë "për" pikat shtesë të rendit të ditës. Tani e vendosim në votim rendin e ditës, bashkë me pikat shtesë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?...

Lirigzon Kastrati: Në rregull janë pikat shtesë, por te pika e 13-të (Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve), në emër të grupit, kërkojmë që kjo pikë të jetë e njëjtë sikurse në seancat e kaluara, me renditje menjëherë pas procesverbalit.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Atëherë, e kemi një propozim të Lirigzonit që pikën e 13-të ta bartim në renditje si pikë të dytë të rendit të ditës. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 12 vota "për" dhe 14 kundër bie propozimi i Lirigzonit dhe kjo pikë mbetet si pikë e fundit e rendit të ditës, për këtë seancë, por edhe për seancat e radhës.

Defrim Kafexhiu: Përshëndetje për të gjithë! I nderuari kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë, të gjithë ju të pranishëm! Urime puna që filloi sot, për mandatin e ardhshëm të këtij kuvendi dhe shpresojmë që të gjithë së bashku do të bëjmë punë të mira për qytetarët e komunës së Rahovecit, sepse për atë edhe jemi zgjedhur. Te kjo pikë, pajtohem me propozimin e Lirigzonit dhe besoj që është gabim që duhet vendosur në votim. Në mirëkuptim me të gjithë anëtarët e kuvendit dhe ekzekutivit, për hir të qytetarëve, kjo pikë të vazhdojë të qëndrojë si pikë e dytë, pas procesverbalit. Meqenëse rendi i ditës për këtë seancë është më voluminoz, të paktën prej seancave të tjera, sepse mendojmë që produktiviteti është më i madh kur diskutimet dhe pyetjet në kërkesat e qytetarëve bëhen në fillim të seancës. Po ashtu, në fund të seancave drejtorët nuk janë prezentë, ku pyetjet dhe kërkesat kryesisht u bëhen drejtorëve të drejtorive.

Kryesuesi: Faleminderit! Ne patëm një propozim, i cili u votua. E thashë edhe më herët, kjo pikë do të jetë si pikë e fundit e rendit të ditës me votën tuaj. Unë e lexova rendin e ditës bashkë me pikat shtesë. Po e vendosi në votim si të tillë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota "për" miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Të nderuar kuvendarë, nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit të mbledhjes solemne? Nëse jo, e vendosim në votim. Atëherë, miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar.

2. Dhënia e betimit të kuvendares znj. Florida Bajraktari dhe kuvendarit z. Behlul Krasniqi:

Kryesuesi: Ju lus të ngriheni në këmbë dhe lexojeni deklaratën.

Florida Bajraktari: Unë, Florida Bajraktari, betohem që do t'i kryej detyrat me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, si dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

Behlul Krasniqi: Unë, Behlul Krasniqi, betohem që do t'i kryej detyrat me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, si dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

Kryesuesi: Urime Floridë, urime Behlul! Ju dëshiroj shëndet dhe suksese në punën tuaj në këtë mandat!

3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa:

Kryesuesi: Kërkoj nga partitë politike që të na japin emrat e shefave të grupeve parlamentare, që më pas t'iu adresohemi për secilën pikë të rendit të ditës.

Feriz Thaqi: Përshëndetje për të gjithë! Shef të grupit tonë, propozoj Berat Durakun, ndërsa si anëtarë të KPF-së: Berat Durakun dhe Saranda Sallteku.

Enis Durguti: Përshëndetje për të gjithë! Urime dhe suksese të gjithë kuvendarëve! I nderuar kryesues, kryetar, drejtorë dhe ju kolegë! Në emër të grupit të LDK-së, shef të grupit e propozoj Lirigzon Kastratin, ndërsa për anëtarë të KPF-së, automatikisht Lirigzoni dhe për kuotën gjinore, propozoj Hazbije Shalën.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryesues, nënkryetar, kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë asambleistë! Urime për të gjithë mandati i ri dhe shpresoj që këtë mandat do të bëjmë punë më të mira sesa në mandatin e kaluar! Në emër të grupit të LVV-së, për shef të grupit e propozojmë Defrim Kafexhiun, njëherit edhe anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi: Faleminderit! Në bazë të formulës së përqindjes u kuptua se kush sa anëtarë i ka në KPF. Komiteti i ka 7 anëtarë dhe kërkojmë propozim edhe prej PDK-së.

Sali Sallteku: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë dhe ju kuvendarë! Urime dhe suksese! Prej PDK-së e kemi Melinda Oruqi-Iska, shefe të grupit dhe anëtare të KPF-së.

Kryesuesi: Ne, veçse i morëm emrat e anëtarëve të KPF-së, si dhe të shefave të grupeve parlamentare. Të merremi vesh saktë, paraprakisht ky është dakordim paraprak i partive politike. Emrat janë këta: Berat Duraku dhe Sarandë Sallteku (AAK), Lirigzon Kastrati, Hazbije Shala (LDK), Defrim Kafexhiu (LVV) dhe Melindë Oruqi-Iska (PDK). E vendosim në votim këtë propozim! Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 26 vota "për", asnjë kundër dhe 1 abstenim, miratohen propozimet për anëtarët e KPF-së.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete:

Kryesuesi: Në këtë komitet, neve si anëtarë të kuvendit na takojnë tre emra.

Berat Duraku: Prej AAK-së e propozojmë Feriz Thaqin.

Lirigzon Kastrati: Në emër të grupit të asambleistëve të LDK-së, e propozojmë dr. Qazim Canën.

Defrim Kafexhiu: Duke marrë parasysh përvojën dhe kontributin pothuajse vullnetar në komitetin tjetër të krijuar në mandatin e kaluar, Komitetin për Shëndetësi, në emër të grupit të LVV-së, për anëtare për Komitetin për Komunitete, e propozojmë Vlora Vuçiterna – Çmega.

Kryesuesi: Sipas përfaqësimit politik me numër të votave, kemi tre propozime për Komitetin për Komunitete: Feriz Thaqi (AAK), Qazim Cana (LDK) dhe Vlora Vuçiterna (LVV). Anëtarët e tjerë do të përcaktohen në koordinim me zyrën e komuniteteve dhe me përfaqësuesit e minoriteteve.

Feriz Thaqi: Kryesues, ndoshta është dashur që edhe PDK-ja të ketë propozim dhe të vendoset në votim?

Kryesuesi: Përfaqësimi në KPF dhe në KK përcaktohet me numër të votave. Kërkoj nga ju një dakordim.

Defrim Kafexhiu: Sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, në komitetet obligative, delegatët e kuvendit përfaqësohen në bazë të përqindjes së votave që i marrim në zgjedhje. Ne edhe mund ta vendosim në votim, por kur të shkon vendimi për shqyrtim në MAPL, do të rikthehet për t'u votuar edhe njëherë në Kuvend.

Melinda Oruqi Iska: Në rregull jemi, pasi nuk lejohet.

Kryesuesi: Faleminderit! Po e vendosim në votim propozimin. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 26 vota pro dhe 1 abstenim, miratohet propozimi për Komitetin për Komunitete.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB):

Kryetari: Përshëndetje! I nderuar kryesues Fatmir Iska, nënkryetar i komunës, Betim Zilanoga! Përshëndetje për drejtorët e drejtorive, ju anëtarë të kuvendit të komunës, OJQ, medie, përfaqësues të LMT-së, qytetarë! Urime për betimin e dy asambleistëve! Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi e ka një udhëzim administrativ, i cili e përcakton se kush mund të jetë anëtar. Ne sot duhet ta marrim vendimin për themelimin e KKSB-së. Këshillin e kryeson kryetari i Komunës. Marrin pjesë: komandanti i policisë, Bashkësia Islame, Teqeja e Madhe e Shehij Sylejmanit, Teqeja e Haxhi Shehij Iljaz Shehut, Milan Stanojeviq nga kisha ortodokse serbe, Bujar Morina nga komuniteti egjiptian, e presim një përfaqësues nga komuniteti rom, Valon Berisha nga komuniteti ashkali, kryesuesi i Komunitetit për Komunitete, Alban Gashi nga Zyra për Barazi Gjinore, Muhamet Morina – drejtor i Arsimit, Erseka Cana – kryetare e këshillit të prindërve, e presim një përfaqësues nga FSK-ja, Enis Berisha – KLSP, Beqir Hamza nga komiteti për emergjencë, Lendrit Qeli – ZKKK, Vjollca Gurgule – OJQ, Shaip Shala – mediat lokale, Mustafë Korenica – komuniteti i biznesit, Adelina Vuçitërna – Komuniteti për Persona me Aftësi të Kufizuara, si dhe Skender Hamza – koordinator i KKSB-së.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Sa për njoftim, kryetari i ka respektuar të gjitha procedurat e thirrjes për aplikim, duke e respektuar publikimin dhe afatin prej 15 ditësh për aplikim. E vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet pika e pestë.

Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për iniciimin e procedurave për themelimin e këshillit për fshatin Hoçë e Madhe:

Kryesuesi: Sot marrim vetëm vendim për themelimin e procedurave. Siç e dini, ekziston edhe ligji për Hoçën e Madhe, si dhe udhëzimi administrativ.

Skender Hamza: Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë! Si procedurë në këtë mbledhje merret vendimi për iniciim të themelimit të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe dhe në mbledhjen e ardhshme do të themelohet komisioni nga anëtarët e Kuvendit. Pas themelimit, sot, ne do ta bëjmë shpalljen në uebfaqen e komunës dhe pas formimit të komisionit nga ju, komisioni i shtjellon aplikimet. Dy anëtarë janë nga fshati Hoçë e Madhe, një përfaqësues nga kisha dhe dy anëtarë nga Kuvendi. Si procedurë shkon rreth tre muaj, deri në themelimin e këtij këshilli.

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! Po e vendosim në votim këtë propozim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota “për” miratohet ky propozim.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës – “Park Hotel Plaza”:

Erhan Morina: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, medie, përfaqësues të LMT-së. Në këtë pikë të rendit të ditës, kërkohet plotësim-ndryshimi i komisionit që është formuar më datë 28.3.2025, për zhvillimin e procedurave të ankandit publik të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, e cila gjendet te “Hotel Park Plaza”. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarësh, 2 nga kuvendi, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

Kryesuesi: Drejtor, a jepet për 99 vjet apo për 25? Është gabim teknik, ju ftoj ta përmirësoni.

Berat Duraku: Nga AAK-ja, në këtë komision do të jetë Dafina Gashi.

Enis Durguti: Nga LDK-ja, propozojmë Lirigzon Kastratin.

Defrim Kafexhiu: Me sa e dëgjova drejtorin, po jepet në shfrytëzim për 99 vjet. Unë po propozoj që afati për dhënien në shfrytëzim të shkurtohet. Sikurse që ka qenë propozimi në mandatin e kaluar, por shkak i zgjedhjeve nuk janë zhvilluar procedurat. 99 vjet është shumë e paarsyeshme të jepet në shfrytëzim një pronë e komunës. Për anëtarë të komisionit e propozojmë Vlora Vuçitërnën.

Melinda Oruqi Iska: Nga PDK-ja, propozojmë Mirsad Shehun.

Kryesuesi: Tani i kemi 4 propozime, ndërsa kërkohen vetëm 2 përfaqësues.

Enis Durguti: Unë propozoj që komisioni të jetë i njëjtë, le të vazhdojë të punojë dhe pa marrë parasysh çka propozojmë ne, ju e kaloni sepse i keni 15 vota, por në disa, komisioni duhet të jetë më bashkëpunues. Propozimi im është që të jetë i njëjti komision, vetëm Erhani të zëvendësohet.

Kryesuesi: Faleminderit për propozimin tuaj! Ne veçse i kemi marrë propozimet dhe meqenëse i kemi 4, duhet t'i vendosim në votim secilin, veç e veç. Kush është "për" Dafina Gashin?... Kundër?... Abstenime?... Dafina i ka 15 vota "për". Kush është "për" Lirigzon Kastratin?... Kundër?... Abstenime?... Lirigzoni i ka 12 vota pro, 14 kundër dhe 1 abstenim. Vazhdojmë me Vlora Vuçitërnë, kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Vlora i ka 11 pro, 14 kundër dhe 2 abstenime. Kush është "për" Mirsad Shehun?... Kundër?... Abstenime?... Mirsadi ka 16 vota pro. Atëherë, Dafina Gashi dhe Mirsad Shehu janë pjesë e komisionit. Nga kryetari kërkohet dy emra nga ekzekutivi.

Kryetari: Faleminderit! Altin Zhuniqi dhe Nora Boshnjaku.

Kryesuesi: Edhe një emër na duhet nga shoqëria civile, do ta plotësojmë në vazhdim. E vendosim në votim këtë vendim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?...

Defrim Kafexhiu: Ju thoni që vendimi është marrë, tani po ndryshohet dhe nëse po ndryshohet, gjithashtu mund të ndryshohet edhe afati i dhënies në shfrytëzim.

Kryesuesi: Vendimi është marrë më herët, ndërsa këtu kemi të bëjmë vetëm me formim të komisionit.

Kryetari: Faleminderit, kryesues! Këtu bëhet fjalë për marrjen e vendimit për plotësim-ndryshimin e komisionit, sepse është përbërje e re e Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Ndërsa, vendimi për dhënien në shfrytëzim deri në 99 vjet është dhënë më herët, pikërisht në atë ditë që është marrë edhe vendimi për formimin e komisionit. Ankandin nuk kemi mundur ta shpallim, për shkak që ka ndodhur dekreti i presidentes për zgjedhjet lokale dhe është pezulluar ankandi publik.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar, për sqarimin! Atëherë, po e vendosim në votim! Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 15 vota "për" miratohet vendimi.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokalit – "Parku i Qytetit":

Erhan Morina: Edhe në këtë vendim, sikurse në vendimin e mëparshëm, kërkohet plotësim-ndryshimi i anëtarëve të komisionit. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga shoqëria civile.

Defrim Kafexhiu: Njëjtë sikurse anëtari i LDK-së që propozoi më herët, meqenëse është vendim i Kuvendit, mund ta ndërrojmë vetëm anëtarin, i cili nuk ka mandat tani dhe nuk mund të jetë pjesë e komisionit. Komisioni le të mbetet me atë përbërje të vendimit të mandatit të kaluar.

Kryetari: Ta sqarojmë një fakt: në Komunën e Rahovecit tani ka bashkëqeverisje në mes PDK-së dhe AAK-së, si dhe duhet ta kuptojmë që ky mandat do të ketë shumë situata që mund të mos jenë të kënaqur të gjithë, por më e rëndësishmja është që të gjithë bashkë duhet të punojmë për të mirën e qytetarëve. Vendimet që i ka marrë Kuvendi për Hotel Park Plazën, si për parkun, janë legjitime dhe e kanë marrë ligjshmërinë e plotë. Sikurse të mos kishim pasur zgjedhje, këto nuk do të ishin temat në këtë Kuvend. Komisionet, jemi të obliguar t'i ndryshojmë, sepse janë procedurat ligjore ato që na detyrojnë. Ne i respektojmë vendimet e Kuvendit dhe ju premtoj që do t'i respektoj të gjitha vendimet që dalin nga Kuvendi.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Të nderuar drejtorë, kolegë anëtarë të kuvendit! I uroj dy asambleistët për betimin e tyre! Po më kujtohet kur kryetari thoshte që “nuk është gjithçka politike” dhe tani po del që gjithçka është politike, me vetë faktin që po ndryshohen komisionet. Unë kam qenë në komisionin për Hotel Park Plaza, së bashku me Melinda Iskën dhe kam kërkuar që këto procedura të pezullohen me vetë faktin që zgjedhjet lokale janë dekretuar. Kam dërguar edhe e-mail te kryetari për këtë çështje, por kanë insistuar që këto procedura të vazhdojnë. Më kanë ftuar në takim dhe drejtori Afrim Oruqi ka kërkuar që të vazhdojmë, sepse është ligjore dhe kërkesa jote është antiligjore. Kam kërkuar sqarim lidhur me këtë nga Zyra Ligjore dhe në komision ka ardhur Isak Hoti, i cili ka deklaruar që komisioni nuk guxon t’i zhvillojë procedurat, pasi me shpalljen e dekretit për zgjedhjet lokale bie ndesh me ligjin. Kjo është arsyeja pse kryetari dëshiron që t’i ndryshojë anëtarët e komisionit.

Kryetari: Ju përfaqësoni grupet politike dhe secili këtu në Kuvend jeni të zgjedhur nga subjektet politike. Unë kam qenë kandidat i një subjekti politik, i kemi fituar zgjedhjet dhe i kemi bashkuar forcat me PDK-në. Duhet ta kuptojmë këtë fakt që bashkë me PDK-në, do t’i aplikojmë praktikat më të mira në shërbim të qytetarëve. Ai që e ka shumicën, ai vendosë dhe kjo është vlera më e madhe e demokracisë.

Jusuf Dërmala: Puna e kohëzgjatjes të dhënies me qira, a është edhe këtu vendimi i njëjtë për 5 vjet, apo mund të ndryshohet?

Erhan Morina: E ceka më herët që vendimi mbetet i pandryshuar, ndërsa në këtë rast formohet vetëm komisioni për zbatimin e procedurave.

Kryesuesi: Faleminderit! Vazhdojmë me propozimet e subjekteve politike.

Berat Duraku: Nga AAK-ja, në këtë komision e propozojmë Florida Bajraktarin.

Lirigzon Kastrati: Nga LDK-ja, propozojmë Enis Durgutin.

Defrim Kafexhiu: Nga LVV-ja, propozojmë Jusuf Dërmalën.

Melinda Oruqi Iska: Nga PDK-ja, propozojmë Flutura Ukajn.

Kryesuesi: Meqenëse edhe këtu kemi 4 propozime, detyrimisht duhet t’i vendosim në votim. Kush është “për” Florida Bajraktarin?... Kundër?... Abstenim?... 15 vota “për” i kemi për Floridën. Kush është për kandidatin e LDK-së, Enis Durguti?... Kundër?... Abstenim?... 11 “për”, 9 kundër dhe asnjë abstenim. Kush është “për” Jusuf Dërmalën?... Kundër?... Abstenim?... 12 pro, 5 kundër dhe 1 abstenim. Kush është “për” Flutura Ukaj?... Kundër?... Abstenim?... 15 vota pro Fluturës, 1 kundër dhe një abstenim. Pra, anëtarë të komisionit nga Kuvendi i Komunës janë Florida Bajraktari dhe Flutura Ukaj.

Kryetari: Nga organizatat joqeveritare është Nazmi Bellaqa, e kemi nga organizata e invalidëve të luftës.

Kryesuesi: Atëherë, po e vendosim në votim komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, lokali – “Parku i Qytetit”, me emrat nga ekzekutivi: Besmire Bytyqi dhe Altin Zhuniqi, nga Kuvendi: Florida Bajraktari dhe Flutura Ukaj, si dhe nga sektori joqeveritar, Nazmi Bellaqa. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota pro kalon ky vendim.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 01 Nr. 181/24, i datës 30.1.2024, i ndryshuar dhe i plotësuar me vendimin 01 Nr. 20/25, i datës 28.2.2025, për caktimin e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara:

Skender Hamza: Këtu kemi të bëjmë me një komitet joobligativ. Komiteti në fjalë ka afat edhe 2 vjet, sepse është themeluar në gjysmë të mandatit të kaluar. Këtu ka qenë anëtar At dhe Rama, tani drejtor i DKRS-së dhe për këtë arsye duhet të marrim vendim që ta plotësojmë-ndryshojmë këtë komitet. Pas miratimit, duhet të hapet konkursi për aplikim (vetëm për një anëtar).

Kryesuesi: Faleminderit, Skender! Në këtë komision kemi 3 anëtarë të Kuvendit, 1 të ekzekutivit dhe 1 të shoqërisë civile.

Berat Duraku: Nga grupi i AAK-së, nuk kemi propozim për këtë komision.

Lirigzon Kastrati: Në emër të LDK-së, propozojmë Qazim Canën.

Vlora Vuçiterna – Omega: Në emër të LVV-së, propozojmë Zana Qanta.

Melinda Oruqi Iska: Nga PDK-ja, e propozojmë Behlul Krasniqin.

Kryetari: Nga ekzekutivi, Afrim Oruqi – drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Vlora Vuçiterna – Omega: Nga sektori joqeveritar, në emër të grupit të LVV-së, propozojmë dr. Lulëzim Krasniqin, i cili është anëtar i një ojq-je për personat me aftësi të kufizuara.

Kryesuesi: Faleminderit, Vlorë! Atëherë, Qazim Cana, Zana Qanta, Behlul Krasniqi, Afrim Oruqi, si dhe Lulëzim Krasniqi. Po e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 25 vota pro kalon ky vendim.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për pagesën e mëditjeve të anëtarëve të komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës:

Kryetari: Ne kemi shkuar në drejtim të rritjes së mëditjeve. Dikur Kuvendi e ka pasur 30€ dhe tani kemi vendosur ta bëjmë 50€ dhe parashihet që të paguhet 3 mbledhje për një komision dhe për një temë të caktuar.

Vlora Vuçiterna – Omega: Rreth kësaj pike nuk kam diçka, por meqenëse është fjala për mëditjet, dua ta pyes drejtorin e Financave se çka ka ndodhur me mëditjet e Komitetit për Shëndetësi, meqenëse kam qenë kryesuese? Sekretaria e Kuvendit e di më mirë, se një pjesë na kanë mbetur borxh.

Afrim Limani: Është i vetmi komitet që e kemi paguar më së shumti dhe në mënyrë të rregullt. Drejtorja për Buxhet dhe Financa është drejtori që merret me ekzekutimin e pagesave dhe ndonjëherë ndodh që nuk na ofrohen me kohë ose fare hiç raportet e nevojshme për ekzekutim. Për respekt ndaj jush, kam shkuar edhe vetë që t’i kërkoj dokumentet e nevojshme. Sidoqoftë, borxhin ndaj Komitetit për Shëndetësi do ta ekzekutojmë brenda këtij viti.

Defrim Kafexhiu: Drejtor, legjislati e përcakton qartë që anëtarët e ekzekutivit që janë anëtarë të komisionit, i rregullojnë procedurat administrative në shërbim të atij komisioni. Për raportet finale do të duhet t’ju drejtohesh kolegëve të tu drejtorë, sepse raportet finale të punës së komisioneve, që duhet t’i sjellin në Drejtori të Financave për pagesë të mëditjeve, duhet të bëhen nga drejtorët që janë anëtarë të komisioneve. Në momentin që raportet nuk dorëzohen, mund të paragjykojmë që po bëhet qëllimshëm që të mos i bësh pagesat.

Kryesuesi: Besoj që ekzekutivi do të kujdeset në momentin kur komisioni e përfundon punën, që ta bëjë raportin dhe të njëjtin ta dorëzojë në Drejtori të Financave. Përndryshe, drejtori edhe ligjërisht është i obliguar që t’i ekzekutojë pagesat. Po e vendosi vendimin për miratim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Në mënyrë unanime kalon pika e dhjetë.

11. Shqyrtimi i raportit të punës së ekzekutivit (kryetarit) për vitin 2025:

Kryetari: Faleminderit kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, drejtorë, nënkryetar, përfaqësues të mediave, të LMT-së dhe të OSBE-së. Ky raport ka kaluar nëpër filtrat e diskutimit në takimin e dhjetorit, është raport publik dhe i qasshëm për qytetarët. Raporti përmbledh punën e ekzekutivit të komunës, janar-dhjetor 2025. Jam këtu, për çdo sqarim dhe përgjigje të nevojshme. Raporti nuk votohet, por vetëm diskutohet.

Enis Durguti: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, kryesues. Nëse më lejohet, po e hapi një diskutim. Raportin e kam lexuar. Kam shumë komente, por do të mundohem të jem sa më i shkurtër. Te pjesa tjetër e komenteve dhe pyetjeve sa i përket raportit, e kam edhe fizikisht dhe mund t’ia dorëzoj kryesuesit, nëse ka vullnet dhe dëshirë do të na përgjigjet. Raporti është i rëndësishëm dhe ligjërisht i domosdoshëm, prandaj i kam disa komente. Së pari, dua të theksoj se raporti në pjesë të madhe është listues i aktiviteteve, por më pak analitik në rezultate të punës. Prandaj, ne shohim çfarë është bërë dhe realisht shumë pak se çka ka ndryshuar për qytetarin. Mungojnë indikatorët e performancës. Mungon krahasimi me vitin paraprak, matjet konkrete dhe ndikimi i politikave komunale. Në pjesën e zotimeve dhe prioritetëve gjuha e përdorur është kryesisht deklarative, me shprehje si: Do të vazhdojmë, do të përmirësojmë dhe do të rrisim. Mungon matja - sa, kur dhe me çfarë rezultati. Kuvendi ka të drejtë të jetë në dijeni se cilat objektiva janë përmbushur plotësisht dhe cilat nuk janë arritur fare. Sa i përket investimeve kapitale, raporti tregon shifra të larta të shpenzimeve, por nuk bën dallim të

mjaftueshëm në mes të projekteve të shpenzuara dhe projekteve realisht funksionale për qytetarët e komunës së Rahovecit. Nuk kemi një pasqyrë të qartë të projekteve të vonuara, të bartura apo që janë përfunduar vetëm në aspektin financiar, jo në shërbim të qytetarëve. Në fushën e shërbimeve publike, raporti paraqet një volum të madh të kërkesave, por volumi nuk është gjithmonë tregues i cilësisë – nuk kemi të dhëna për kohën mesatare të trajtimit të këtyre kërkesave, për ankesat e qytetarëve, apo për problemet administrative që janë hasur gjatë vitit 2025. Te sfidat, përmendet buxheti i pamjaftueshëm, vonesat nga niveli qendror dhe mungesa e kapaciteteve, por raporti nuk tregon qartë se çfarë ka bërë konkretisht ekzekutivi komunal për t'i adresuar këtu sfida. Në përmbyllje, për të mos e zgjatur më shumë, ky raport tregon se çfarë është bërë administrativisht dhe nuk tregon mjaftueshëm se sa është përmirësuar jeta e qytetarëve të komunës së Rahovecit. Prandaj, si Kuvend, duhet të kërkojmë më shumë analizë, më shumë matje dhe më shumë llogaridhënie, sepse vetëm kështu raportet vjetore shndërrohen në dokumente formale dhe instrumentale në përmirësimin e qeverisjes lokale. Këtu i kam edhe disa pyetje rreth raportit, por meqë është seanca e parë do t'ia dorëzoj fizikisht kryesuesit dhe nëse keni vullnet do të ishte mirë ta shikoni edhe njëherë këtë raport me këto pyetje.

Kryetari: Faleminderit! Besoj që gjatë kësaj periudhe 4-vjeçare do të kemi mundësi t'i qartësojmë disa prej pozicioneve. Raporti është obligativ dhe secila drejtori e bën raportin e vet vjetor dhe e publikon në uebfaqe të komunës. Raporti i përmban zotimet, prioritetet, qëllimet dhe synimet, si dhe angazhimet, arritjet, sfidat dhe ngecjet gjatë vitit. Mos ta ngatërrojmë raportin e performancës, është një raport tjetër që ka indikatorët e saj. Komuna e Rahovecit e plotëson këtë raport për çdo vit, në bazë të indikatorëve. Mos ta ngatërrojmë raportin e punës me kontratat që janë në vazhdim, ose kontratat që kanë filluar, sepse për këto raporton Zyra e Prokurimit. Me kohë do ta kuptojmë se çka është raporti i punës së kryetarit dhe i ekzekutivit, çka është raporti i performancës, çka është raporti që përmbledh kontratat e nënshkruara, çka është raporti financiar, raporti i obligimeve kontraktuale etj. Në raport i kemi të specifikuar me centimetra se sa kanalizim, sa rrugë, sa trotuare, sa fusha e sa parqe janë bërë. Në raportin e punës nuk mund të përmbliidhen të gjitha, sepse ka edhe raporte të tjera që mund t'i qartësojmë këto gjëra. Sidoqoftë, kushdo që ka vërejtje dhe komente, ne e mirëpresim, sepse ndikojnë që të rritet përkushtimi i komunës për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Angazhimi ynë se sa e ka përmirësuar jetën e qytetarëve është vërtetuar më 12 nëntor dhe më 9 nëntor. Vazhdojmë me punë të mira, sepse nuk do të ndalemi.

12. Shqyrtimi i raportit financiar, janar – dhjetor 2025:

Afrim Limani: Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë!

Më lejoni që t'ju uroj një fillim të mirë të punës, që brenda këtij mandati të keni shëndet dhe suksese. Raporti financiar për vitin 2025, për dallim prej raporteve të tjera financiare - 3-mujore, 6-mujore dhe 9-mujore, ky raport është më i gjerë dhe më voluminoz. Në raport janë të futura të gjitha ngjarjet financiare që kanë ndodhur gjatë vitit 2025. Gjithashtu është përfshirë edhe pjesa analitike e të gjitha të hyrave dhe të gjitha shpenzimeve, si dhe të gjitha ngjarjeve të tjera që kanë ndodhur brenda këtij viti. Ky raport përbëhet nga pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit, kontratat e lidhura gjatë vitit 2025, obligimet financiare, obligimet kontraktuale, duke i përfshirë të gjitha kategoritë ekonomike. Të hyrat për vitin 2025 në total janë: 2.189.536 dhe kur e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar e kemi një ndryshim pozitiv prej 341.000€ (pjesa e të hyrave të rregullta, pa gjoba të gjykatës dhe të trafikut). Në faqen numër 5 janë të paraqitura të gjitha të hyrat, duke i përfshirë të hyrat e rregullta, gjobat e gjykatës dhe të trafikut që përfshijnë shumën prej 2.495.000€. Ju në raportet e juaja nuk e keni raportin 3-mujor të gjykatave dhe të trafikut, mirëpo këto kanë ardhur ndërkohë dhe totali i inkasimit është 127.000, që historikisht është një raport më i mirë deri më tani në komunën tonë. Në fund, të hyrat në total rriten dhe bëhen 2.623.000 dhe kur e bëjmë krahasimin me vitin e kaluar, rezultatin e kemi plus 411.352€. Në raport janë të paraqitura edhe disa të dhëna të tatimit në pronë dhe për shkak të sistemit nuk kemi mundur t'i gjenerojmë edhe disa të dhëna, por do t'i kemi shumë shpejt. E kemi paraqitur edhe shpenzimin e buxhetit në kategorinë mallra dhe shërbime, duke përfshirë kategoritë ekonomike për të gjitha drejtoritë. Në faqen 18 i kemi të përshkruara kontratat që janë lidhur gjatë vitit

2025 (14.750.000€). Mos të harrojmë, në këto kontrata i kemi tri projekte madhore, të cilat financohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe kur e zbresim atë vlerë, nga buxheti ynë janë të lidhura vetëm 2.615.000€. Në raport janë të paraqitura të gjitha obligimet financiare. Kategoria mallra dhe shërbime, 8003.000, komunal 38.201, subvencione 220.000, investime kapitale 1.884.000 dhe krejt së bashku janë 3.357.000. Në raport janë të përfshira edhe obligimet kontraktuale që në total janë 12.319.000€. Për fundi, shpenzimi i buxhetit është 99.96%.

Jusuf Dërmala: Përshëndetje për të gjithë! Herën e parë nuk ju përshëndeta të gjithëve, meqenëse është hera e parë që po e marr fjalën. Në raportin analitik për vitin 2025, te shpenzimet dallohet muaji nga muaji i shpenzimeve për derivate. P.sh: Gjatë muaji tetor, kur kanë qenë zgjedhjet ka shpenzime prej 19.000€. Mos rastësisht i keni shfrytëzuar veturat për fushatë? Në janar, shpenzimet kanë qenë 2372€, në shkurt 2005€, mars 3135€, në qershor dallohet me 12.662€ dhe tetori në realitet është 19.943€. Kjo gjendje më bën të dyshoj që veturat janë shfrytëzuar për fushatë.

Afrim Limani: Jusuf, faleminderit shumë për pyetjen! Ajo çka pretendon ti, nuk ka lidhje fare. Pasi je për herë të parë më lejo t'i shpjegoj disa gjëra. Shpenzimet dhe derivatet i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime dhe nuk ndodh çdoherë që një faturë ta shpenzojmë brenda një muaji, diku më shumë e diku më pak. Ka periudha mujore që ndoshta nuk kemi fare buxhet. Në momentin kur kemi para në dispozicion ne i kryejmë faturat. Në tetor, shpenzimi nuk është realisht në tetor dhe në atë kohë automjetet i kanë shfrytëzuar edhe KQZ-ja. Ne, për mallra dhe shërbime i kemi diku 2.7 milionë dhe këto ndahen për arsim, shëndetësi dhe administratë. Këtu jemi shumë të kujdesshëm dhe presim deri në alokimin e parave dhe tani e kemi mundësinë buxhetore për t'i përfunduar faturat që i kemi në pritje.

Jusuf Dërmala: Nuk jemi duke folur për pagesa, jemi duke folur për faturat që janë krijuar në muajin tetor. Është dallim i madh dhe thjeshtë kërkoj sqarim më të detajuar.

Afrim Limani: Ajo që e the ti, ndërlidhet me shpenzim të buxhetit. Kemi obligime financiare, por këtu varet edhe kur operatori e sjell faturën. Supozojmë që ne kemi bërë shpenzim në shtator, ndërsa operatori faturën e sjell në tetor, apo edhe i vonon më shumë.

Kryetari: Ne duhet ta kuptojmë që në shpenzimet e karburanteve, marrin pjesë edhe zjarrfikësit dhe çdo veturë zyrtare, madje në kohën e fushatës edhe veturat e KQZ-së. Ju siguroj 1 milion %, që asnjë veturë zyrtare e as e kryetarit nuk është përdorur për qëllime fushate, megjithëse kryetarit të komunës i lejohet 24 orë shfrytëzimi i veturës zyrtare. Për fushatë, kam marrë makinë me qira, ndërsa drejtorët e kanë pasur të qartë dhe e dinë që automjeti zyrtar nuk bën të përdoret për fushatë. Gjithashtu, ne e kemi edhe një "Jeep" që bukur shpenzon, të cilin ia kemi dhënë policisë, sepse ata nuk kanë automjete të mjaftueshme.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Sa për sqarim, sipas rregullores, kuvendari ka të drejtë ta marrë fjalën një herë. Ne mund ta bëjmë interaksion bisedën, por vetëm jashtë sallës. Meqenëse është hera e fundit, nëse keni edhe diçka?

Jusuf Dërmala: Dua ta besoj atë që e tha kryetari, por megjithatë është diskrepancë e madhe në mes të muajve. Tjetër, në lidhje me raportin financiar: 12 milionë euro janë obligime kontraktuale. Ligji i prokurimit thotë që projektet nuk guxojnë të nisen pa zotimin e mjeteve, ta keni parasysh! Është vepër penale.

Kryetari: Çka parashihet me ligj, e kemi të qartë! Ne punojmë sipas ligjit dhe qytetarët e dinë shumë mirë. Ndërsa, nëse ka shkelje ligjore, nëse nuk e dimë unë e ti, janë njerëzit kompetentë dhe marrin masa për ndëshkim. Ke të drejtë, mirëpo të lutem mos u shqetëso për atë punë, sepse krejt veprimtaria jonë bazohet në mandatin që e kemi dhe në vullnetin e qytetarëve që na kanë besuar, si dhe në përkushtimin tonë që ta zbatojmë ligjin.

Kryesuesi: Faleminderit! Besoj që me shpjegim e përfundoi kryetari, si autoritet më i lartë dhe për të gjitha gjërat e tjera, mund të diskutojmë edhe jashtë sallës, shoqërisht e politikisht.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, janar-dhjetor 2025:

Veton Mustafa: I nderuari kryetar i komunës, Smajl Latifi, nënkryetar, kryesues i Kuvendit, anëtarë të Kuvendit, medie dhe të gjithë të pranishmit! Në cilësinë e kryetarit të komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, sot, po e prezantoj raportin e punës. Fatkeqësitë natyrore kanë shkaktuar dëme në

komunën e Rahovecit, sidomos në muajin prill për shkak të ngricave pranverore, ku ka qenë i përfshirë tërë territori i komunës së Rahovecit. Dëme më të mëdha ka pasur në pemë dhe në dru frutore. Një pjesë shumë e vogël, më 6 qershor, në zona vreshtare. Në sektorin e perimekulturës, më datë 4 gusht, ka pasur pasoja të mëdha në kulturën e specit, shalqirit, pjeprit, kungullit etj. Komisioni ka pranuar 286 kërkesa dhe nga këto kërkesa, konstatohet që 197 janë miratuar, kurse 89 janë refuzuar. 195 kërkesa kanë qenë në sektorin e bujqësisë, 1 kërkesë në amvisëri, 1 kërkesë në fabrikën Ritupark në Sapniq, sepse fabrika për përpunimin e plastikës është dëmtuar nga zjarret. Dëmet më të mëdha janë në sektorin e pemëve, ku janë dëmtuar 74 hektarë në pemë dru frutore, sidomos në kulturën e kumbullës, dardhës, arrës, ftoit etj. Dëmet në bujqësi janë 530.496€, ndërsa dëmet në fabrikën e plastikës janë 4.493.000€. Gjithsej vlera e dëmit për vitin 2025 është 5.023.502€.

Lirigzon Kastrati: I kemi disa kërkesa rreth kësaj pike dhe pikës së ardhshme. Këtu po e shohim vetëm vendet që janë shkaktuar dëmet, por neve na interesojnë bujqit, kush janë ata? Pse të mos jetë në dijeni edhe kuvendi, se cilët janë ata që janë dëmtuar? Vitin e kaluar e kemi miratuar një raport, a është i njëjti ky? Faleminderit!

Veton Mustafa: I nderuar, për shkak të privatësisë nuk i kemi futur emrat. Komisioni komunal i ka të gjitha të dhënat e sakta, për çdo fermer dhe për çdo parcelë. Agjencia për Informim dhe Privatësi na ndalon këtë gjë.

Kryesuesi: Faleminderit, Veton! Atëherë, e vendosim në votim vendimin. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet ky vendim.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e raportit komunal për vlerësimin e dëmeve nga reshjet e shiut, 5,6,7 janar 2026:

Kryesuesi: Paraprakisht, e falënderoj kryetarin për këtë angazhim të madh së bashku me ekzekutivin, por edhe me aktorët e tjerë.

Kryetari: Faleminderit, kryesues! Më datë 5,6,7 janar të këtij viti ka pasur reshje intensive të shiut, me ç'rast ekipet tona komunale, zjarrfikësit, policia, kompanitë e kontraktuara dhe vullnetarët janë përballur me këto tri ditë me situatë të vështirë, e cila ka prodhuar edhe shtabin emergjent me vendim të kryetarit të Komunës. E falënderoj komisionin e përhershëm, të cilin e kryeson Veton Mustafa dhe anëtarët e tjerë të komisionit, si dhe 5 nënkomisionet që i kam themeluar. Në një afat rekord kanë bërë pranimin e ankesave nga palët e të dëmtuarve dhe natyrisht kanë shkuar edhe në terren për vlerësimin e gjendjes në: amvisëri, ekonomi familjare, biznese, infrastrukturë publike dhe në bujqësi. Raporti është përfundimtar dhe ky raport duhet t'i nënshtrohet diskutimit dhe votimit në kuvend, sipas standardeve të kërkuar nga komisioni qeveritar për kompensimin e dëmeve. Nëse e bëjmë një krahasim të dëmeve të shtatorit 2022 dhe të dëmeve janar 2026, del që 1.192.000€ kanë qenë dëme në amvisëri në vitin 2022, ndërsa tani i kemi 292.457€. Dëmi në këtë rast është 4 herë më i vogël, sepse është arritje dhe përkushtim i autoriteteve komunale, duke ndikuar në hapjen e vijave, trajtimin e shtetërve dhe kanaleve të kullimit etj., që megjithatë e kanë lehtësuar qarkullimin e shiut, duke i parandaluar dëmet. Dëmet janë fokusuar më shumë në disa zona, kryesisht në Fortesë, Xërxë, Malësi të Vogël, Krushë e Madhe, Celinë, Hoçë e Vogël, Brestoc dhe Çifllak. Gjithsej, vlera e dëmit është 671.749€, në ekonomi familjare, biznese dhe në infrastrukturë private. Në infrastrukturë publike është 129.000€. Raporti për infrastrukturë publike nuk i nënshtrohet miratimit në Kuvend, sepse dërgohet direkt në Ministrinë e Planifikimit. Gjithsej, dëmi i shkaktuar është 801.000€, ndërsa në shtator të vitit 2022 e kemi pasur një situatë krejt tjetër dhe vetëm në amvisëri i kemi 1.192.509€. Raporti nuk ka emra dhe mbiemra, sepse e kemi të ndaluar. Kush dëshiron t'i shohë emrat, ju lutem mund të keni qasje sipas ligjit në dokumente publike. Ndërsa, në komision qeveritar, raporti dërgohet me emra dhe mbiemra. Prandaj, i falënderoj edhe një herë të gjithë ata që kanë kontribuar, posaçërisht për punën kolosale të komisionit të përhershëm dhe 5 nënkomisioneve. I falënderoj drejtorët, nënkryetarin, kryesuesin, që kanë qenë pjesë e shtabit në përballimin e asaj shtate emergjente. Sapo t'i miratojmë këto raporte, kemi premtim nga kryetari i komisionit qeveritar që do të dëmshpërblehen ata që janë dëmtuar.

Bujar Mustafa: Përshëndetje për të gjithë! Dëshiroj ta ngre një shqetësim prej praktikave të kaluara kur janë bërë raportet. Në kontaktet me qytetarët në terren, kemi vërejtur që ka pasur raporte që janë dërguar në Prishtinë, por atje

kanë munguar fotot. Kemi pasur raporte ku qytetarët nuk kanë pësuar dëme, por janë kompensuar. Kemi qytetarë që janë dëmtuar, i kanë dërguar edhe raportet edhe fotot, por mjetet nuk i kanë marrë. Ndërsa, ato që i përmendi kryetari, Hoçë e Brestoc nuk ka dëme për sivjet, por ne kemi parë që edhe nëpër shtëpi iu ka hyrë uji dhe nuk e di në çka bazohet kryetari kur tha që ata kanë dalë të padëmtuar.

Kryetari: Fakti që dëmet në amvisëri janë 292.000€, atëherë nënkupton që ka pasur dëme dhe iu ka hyrë uji në shtëpi. Mirëpo, thashë që në vitin 2022 dëmi ka qenë 1.192.000€, pra, ka një situatë më të mbrojtur, për shkak të veprimeve të shumta që kanë ndodhur nga Komuna e Rahovecit. Ndërsa, ka qytetarë që i kanë mbuluar vijat, kanë ndërtuar shtëpi dhe parking andej në anë të lumit, si dhe ka qytetarë që tentojnë të improvizojnë situatën. Mirëpo, komisioni ynë dhe komisioni qeveritar është për ta bërë verifikimin. Me lejen e komisionit qeveritar, në diskrecion të komisioneve t'i vlerësojmë me çmim, kushtimisht një kuzhinë a ka kushtuar 1000€ me çmim të tregut, apo 10.000€. Pra, unë besoj që ky raport mund të përmirësohet, sepse mund të ketë njerëz nga ata që i kanë numrat e telefonit, por nuk i kanë xhirollogaritë aktive. Për sa i takon profesionalizmit, unë i besoj komisionit dhe raportet tona janë përdorur si model në AME. Unë besoj që do të na shkrejë kësaj radhe dhe nëse po, atëherë do të na paguhen dëmet e vitit 2022, 2023, 2024, 2025 dhe 2026.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! A ka dikush tjetër diçka? Nëse jo, atëherë po flas unë pak. Është bërë një punë shembull nga kryetari i Komunës dhe komisioni në hartimin e këtyre raporteve. E inkurajoj kryetarin të vazhdojë me këto punë të mira e ishalla në të ardhmen do të kemi vërshime sa më pak. E vendosim në votim vendimin, kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Në mënyrë unanime, miratohet ky vendim.

15. Formimi i komisionit për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës:

Kryesuesi: Edhe këtu do të kërkojmë 2 anëtarë nga kuvendi dhe ekzekutivi, ndërsa komisioni ka mandat 2-vjeçar.

Berat Duraku: AAK, nuk kemi propozim.

Lirigzon Kastrati: LDK, propozojmë Enis Durgutin.

Defrim Kafexhiu: LVV, propozojmë Bujar Mustafën.

Melinda Oruqi Iska: PDK, propozojmë Flutura Thaqin.

Kryesuesi: Atëherë i kemi tre propozime. Kush është “për” Enis Durgutin?... Kundër?... Abstenime?... 15 vota pro, 2 kundër, 2 abstenime. Kush është “për” Bujar Mustafën?... Kundër?... Abstenime?... 16 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim. Kush është “për” Flutura Ukaj Thaqin?... Kundër?... Abstenime?... 18 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Atëherë, 2 anëtarët nga kuvendit janë: Bujar Mustafa nga LVV dhe Flutura Ukaj Thaqi nga PDK.

Kryetari: Nga ekzekutivi është Afrim Dina dhe Afrim Limani, si dhe nga sektori joqeveritar Adelinë Paqarizi.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Atëherë, komisioni për shqyrtimin e ankesave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës komunale përbëhet nga këta anëtarë: Bujar Thaqi, Flutura Ukaj Thaqi, Afrim Dina, Afrim Limani dhe Adelinë Paqarizi. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, Flutura Ukaj Thaqi, nuk bën të jetë në këtë komision, sepse është në një komision tjetër. Duhet ta propozoni dikë tjetër.

Melinda Oruqi Iska: Nuk kemi anëtarë që e plotëson kuotën gjinore nga PDK-ja. Propozoj Yllka Shehun nga LDK-ja.

Kryesuesi: Kush është “për” Yllka Shehun? Unanimisht pra. Atëherë, tani e vendosim në votim vendimin, kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Unanimisht aprovohet pika e 15-të.

16. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Defrim Kafexhiu: E kam një pyetje për kryetarin: Çfarë mendimin keni për Edon Canën dhe a ka qenë problem të merreni vesh me të për punën e koalicionit, duke e pasur parasysh qasjen edhe diskutimet gjatë debateve zgjedhore?

Kryetari: Unë kam mendim të mirë edhe për Defrim Kafexhiun, për Edon Canën dhe për çdo shqiptar. Ka përplasje dhe dallime konceptuale në metodologji, mirëpo, ka shumë pika që i bashkojnë qëllimet tona për të mirën e përgjithshme. Nëse edhe ju doni të na ndihmoni në këtë përpjekjen tonë kolosale, jeni të mirëseardhur, Defrim!

Vlora Vuçiterna – Çmega: Nuk kam pyetje, por dua ta ngre çështjen e problemit me ngrohje nëpër shkolla. Në disa shkolla të komunës së Rahovecit, e veçanërisht në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori” ka problem të theksuar. Kemi pranuar mesazhe të shumta nga nxënësit e kësaj shkolle, të cilat janë drejtuar me shkresë zyrtare te drejtori i shkollës. Para përfundimit të gjysmëvjetorit të parë, kam reaguar për herë të parë për këtë problem dhe pas këtij reagimi drejtori tanimë i Shëndetësisë, Afrim Oruqi, ka dalë me një video publike, duke tentuar ta demantojë problemin, njëherit më ka ftuar që t’i vizitojë këto shkolla dhe ta shoh që “gjendja është në rregull”. Sot, po e ftoj drejtorin e Shëndetësisë, që ai personalisht të shkojë t’i vizitojë këto shkolla dhe nga afër ta prekë gjendjen faktike në terren. A keni plan ta ndërmerri ndonjë veprim konkret për këtë çështje, sidomos në shkollën “Gëzim Hamza – Piktori”? Ju keni dalë me reagim që ngrohja është në rregull, por gjendja në shkolla është ndryshe prej asaj që ju e thoni.

Lirigon Kastrati: Një pyetje për drejtorin e DKA-së, për tërheqjen e licencave nga ana e MASHT-it? Në udhëzim administrativ dhe në ligj, specifikohet që DKA-ja duhet ta formojë një komision për këtë procedurë. A ka ekzistuar një komision i tillë? Cili është veprimi juaj në të ardhmen? Për Drejtorinë e Bujqësisë: E kam një kërkesë të vazhdueshme nga qytetarët e Hoçës së Vogël, Brestocit dhe Nagacit. Gjendja e rrugëve fushore është e mjerueshme. Rruga “Zona Operative – Pashtriku” është e pakalueshme, e kam bërë gjithashtu një reagim në facebook, por pa reagim. A keni ndonjë pilot-projekt për këto çështje, sepse ka 4 vjet radhazi që i kam këto kërkesa. Te çështja e shtratit të lumit, gjithashtu ka 4 vjet që nuk është bërë asnjë investim te shtrati i lumit për këto 5 fshatra. Veprimin e fundit e ka bërë një qytetar me vetiniciativë, Shaqir Krasniqi, i cili e ka bërë hapjen e një kanali, sepse në shtëpinë e tij dhe të vëllait të tij, uji ka depërtuar brenda dhe besoj që komisioni ka qenë për verifikim. Kërkoj në mënyrë urgjente nga ana e komunës, që këto kërkesa t’i ketë në vëmendje të qartë. Kur pritet të fillojë ky projekt? Ka 4 vjet që nuk është vepruar dhe është ritenderuar përsëri.

Enis Durguti: Unë po ju kursej këtë herë nga pyetjet politike, por dua ta bëj një kërkesë teknike nëse ka mundësi. E lus sekretarinë e kuvendit apo kush është përgjegjës, që kur të kemi seanca të sigurohet parkingu për anëtarët e kuvendit, në veçanti ata që vijnë nga fshatrat. Kërkesa ime është teknike për seancën e ardhshme.

Muhamet Morina: Përsëritje, kryesues i asamblesë komunale, kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, shumë të respektuar asambleistë dhe asambleiste! Fillimisht ju uroj sukses në këtë legjislaturë dhe uroj që të bëjmë punë të mira së bashku! Të jeni të bindur që si drejtor i DKA-së do të jem bashkëpunues dhe e di që sfidat i kemi të përbashkëta, andaj edhe zgjidhjet duhet t’i gjejmë bashkërisht. I dëgjova me vëmendje të madhe pyetjet e asambleistes Vlora. I kam lexuar edhe shkrimet e saj gjatë kohës, sidomos kur filloi gjysmëvjetori i dytë i këtij viti shkollor. Me të vërtetë jemi ballafaquar me sfida të ndryshme, kryesisht me ngrohje nëpër shkolla dhe që nga data 5 janar (datë kjo kur jam emëruar drejtor i DKA-së) nuk kanë reshtur përpjekjet tona që t’i tejkalojmë këto sfida. E kam vizituar shkollën “Gëzim Hamza – Piktori” dhe shkolla në fjalë ka ende vështirësi të theksuara me nxemje, por si Drejtori e Arsimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, me të dëgjuar për këto vështirësi në këtë shkollë, jemi interesuar dhe e kemi blerë një korrektor për stabilizim të energjisë elektrike, i cili ka kushtuar mjaft. Sot është e hënë dhe nuk e di se cila është gjendja, por shpresoj që procesi edukativo-arsimor është duke vazhduar normalisht. Sa iu përket lëndëve djegëse, e kemi zgjidhur këtë çështje dhe të gjitha shkollat tani janë të furnizuara mjaftueshëm me pelet dhe lëndë të tjera djegëse. Te çështja e licencave: Të gjithë jeni dëshmitarë që në mediat e Kosovës u bë alarm puna e licencimit dhe e rilicencimit të mësimdhënësve në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Skender Kastrati” në Malësi të Vogël. Fjala është për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe të mosndjekjes së procedurave ose hapave që duhet ndjekur për t’u licencuar një mësimdhënës. Fillimisht, për të kërkuar një licencë të rregullt në departamentin e licencimit në Ministrinë e Arsimit, mësimdhënësi i cili ka kërkesë për t’u licencuar, duhet të ketë kredi të mjaftueshme, ose të ketë ndjekur mjaftueshëm trajnime për t’ia dhënë vetës dritën e gjelbër për një proces tjetër të vlerësimit. Ekzistojnë 5 formularë. I pari është që ai duhet të ketë kredi të mjaftueshme për ta nisur procesin e vlerësimit të tij, formulari i radhës është vetëvlerësimi, formulari i tretë është vlerësimi i performancës nga drejtori i shkollës, formulari i katërt është një vlerësim nga nxënësit dhe i pesti ka të bëjë me pikët që mësimdhënësi i merr nga

4 formularët e parë. Tutje merret një notë kaluese dhe je i gatshëm t'i nënshtrohesh një kërkesë, duke iu drejtuar departamentit të licencimit dhe kështu fiton një licencë të rregullt. Fjala në këtë shkollë është për shkelje të procedurave dhe aspak për nga cilësia dhe përmbajtja e mësimdhënies. Mendoj që janë vetëm gabime teknike, të cilat njëjtë i ka vlerësuar edhe Ministria e Arsimit. Këtë shkollë e ka vizituar inspektorati i Gjakovës dhe i ka gjetur këto shkelje teknike. Inspektorati i ka përpiluar 4 procesverbale dhe është drejtuar te ne me disa rekomandime. Si DKA, iu kemi përmbajtur 100% rekomandimeve të dala nga ky procesverbal, të njëjtin e kemi përcjellë te Zyra Ligjore dhe pas këtij hapi, drejtori në fjalë, duhet të paraqitet në komisionin disiplinor. Rekomandimi i dytë ishte formimi i komisionit për vlerësimin e performancës dhe mbikëqyrjen e procesit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. Këtë komision e kam formuar menjëherë dhe është funksional, si dhe në ditët në vazhdim do të vazhdojmë nëpër shkolla, t'i shikojmë dosjet e mësimdhënësve që janë në proces të licencimit. Pyetja tjetër më duket ishte se a ka ekzistuar ky komision? Po, komisioni ka ekzistuar, mirëpo, me një vendim të ri, e kemi ndryshuar përbërjen e këtij komisioni dhe tani komisioni e ka një zyrtar të DKA-së, një pedagog ose psikologe, dy mësimdhënës dhe një drejtor shkolle, gjithsej 5 anëtarë. Shpresoj që vlerësimi të shkojë në rregull dhe tutje të mos kemi vështirësi të tilla.

Lirigzon Kastrati: Nëse thoni që komisioni ka ekzistuar, mirëpo nuk ka dalë në terren për t'i bërë vlerësimet.

Muhamet Morina: Unë mund të përgjigjem vetëm prej pjesës që e kam marrë detyrën si drejtor. Unë mendoj që edhe ai komision ka punuar. Dëgjo, duhet të ketë një bashkëpunim të mirëfilltë në mes të drejtorëve të shkollave dhe komisionit për vlerësim të performancës, sepse komisioni nuk është në rolin e policit. Mësimdhënësit duhet t'i kërkojnë të gjitha paqartësitë drejtë licencimit. Komisioni i tanishëm nuk do ta lëshojë asnjë hap procedural.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Pyetje për drejtorin e Shëndetësisë: Drejtor, kur e keni në plan t'i funksionalizoni analizat në laboratorin e biokimisë? Meqenëse kam informata të sakta, që përveç analizave bazike që është hemogrami, analiza të tjera, si: sheqeri, glukoza dhe trigliceridet nuk janë duke u bërë në laboratorin e QKMF-së. Nëse është problemi te aparati, është mirë ta funksionalizoni, nëse është problemi te reagjentët është mirë të furnizoheni dhe së paku pacientëve në QKMF t'u bëhet zgjidhje.

Erhan Morina: Lidhur me pyetjen e Lirigzon Kastratit, se a do të jetë rrugë fushore? Jemi dëshmitarë të gjithë se janë kryer e trajtuar plot rrugë fushore. Planifikimet janë që edhe këtë vit do të ketë rrugë fushore, njëkohësisht është premtim i kryetarit që gjatë këtij mandati të trajtohen dhe të shtrohen rreth 150 km.

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të Kuvendit! Po e njoftoj Vlorën dhe njëkohësisht po e falënderoj për kujdesin që e ka për Drejtorinë e Shëndetësisë. Aparati është funksionalizuar dhe tani është funksional. Vlora ishalla nuk ka nevojë, por të gjithë ata që kanë nevojë për analiza, le të drejtohen në laborator në QKMF. Vlorën e ftoj që të kujdeset edhe për problemet e tjera që i prekin qytetarët. Aparatet servisohehen edhe prishen, edhe në laboratorë privatë, si dhe në QKMF, por gjithmonë rregullohen dhe rikthehen në shfrytëzim.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Unë këto ankesa i kam pasur para një jave, por nëse e keni funksionalizuar është mirë të dilni së paku me një lajmërim. Përndryshe, po me vjen mirë që është rregulluar.

Kryetari: Faleminderit! Nuk po guxojmë ta bëjmë shumë publike, sepse tani të gjithë kanë dëshirë t'i bëjnë analizat, meqë analizat bëhen edhe kur je shëndoshë e mirë. Është e vërtetë që kemi pasur problem me aparatën dhe me kompaninë për servisim, sepse paratë i ka marrë thesari. Tani kemi arritur të bëjmë një pagesë dhe aparati është gati. I mirëkuptoj qytetarët për shqetësimet e tyre, problemi ndoshta nuk ka qenë i vogël, por operatori nuk ka dashur ta rregullojë sepse e ka lidhur punën me një pagesë, të cilin ne nuk kemi arritur t'ia bëjmë, për shkak të thesarit.

Defrim Kafexhiu: Një pyetje për ekzekutivin, qoftë për drejtorin e Urbanizmit, qoftë për kryetarin. Projekti i sheshit qendror të qytetit në çfarë faze është dhe kur pritet të vazhdoen punimet? Një vërejtje: Përveç shumë rrugëve që janë të amortizuara, që kanë nevojë të rregullohen, është një problem shumë serioz te projektet e reja, sikurse rruga "Gëzim Hamza – Piktori", në të cilën janë bërë punime nëntokësore, si dhe janë shtruar 2 shtresa asfalt. Në këtë

projekt, menaxher i projektit ka qenë Përparim Krasniqi. Si mund të ndodhë kur të shtrohet një rrugë e re dhe në më pak se një vit, në po të njëjtën rrugë, të humbet nivelizimi i puseve të kanalizimit (shakteve)? A e mbani në përgjegjësi kompaninë që po i kryen këto shërbime, apo është problemi te mbikëqyrja që komuna e bën? Këto ndodhi te projektet e reja janë turp për institucionin dhe për kompaninë që i ka kryer punimet. Çka duhet të bëjë komuna tani?

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë! Defrim, po më vjen mirë që po interesohesh për sheshin. E dimë që në legjislaturën e kaluar, brenda këtij kuvendi, shumë e keni kundërshtuar sheshin, por erdhën festat e fundvitit me aktivitete, ku fokusi kryesor qytetar ishte te sheshi qendror. Jemi në fazën e vendosjes së pllakave në shesh dhe punimet do të vazhdojnë në moment që përmirësohen kushtet atmosferike, duke vazhduar me vendosjen e ulëseve, rregullimin e ndriçimit etj. Parkingu nëntokësor është i përfunduar dhe shumë shpejt në këtë kuvend, pas pranimit teknik, do të jetë për t'u dhënë në shfrytëzim. Parkingu nëntokësor, për arsye të mirëmbajtjes, ende nuk po lëshohet në shfrytëzim edhe pse është i gatshëm.

Kryetari: Jam plotësisht dakord me rrugën "Gazim Hamza", vetëm një shtesë e ka pasur operatori, unë kam kërkuar nga operatori që ta bëjë edhe shtresën e dytë, sepse të parën e ka bërë keq dhe më pas keq e ka bërë edhe të dytën. Operatori ka marrë penalizime, nuk është paguar dhe ia kemi ndërprerë kontratën, fatbardhësisht, në mënyrë të dyanshme. Parimisht, i kam thënë që "të gjitha makineritë i paske, por nuk po din me punu". Rruga në fjalë do të trajtohet me mirëmbajtjet që i kemi. Do të futet edhe një gyp i madh për ujëra të zeza, do të hapet edhe një herë, mirëpo do të punohet mirë me operatorët e kontraktuar tani. Pra, nuk është bërë pagesë e dyfishtë dhe pothuajse duke mos u futur në detaje, nuk është bërë pagesë fare. Defrim, ti shprehe pak pakënaqësi, ndërsa unë po shprehi më shumë. Ndër punët më të dobëta që kanë mundur të ndodhin. Mbikëqyrje ka çdoherë, mirëpo nuk është që ne me mbikëqyrje jemi krenarë, por në momentin që i kemi parë efektet e punës jo cilësore, kemi ndërhyrë menjëherë. Shtresa e dytë ishte penalizim dhe kemi shpresuar që do të ketë ndikim në përmirësimin e situatës, por jo. Mbi të gjitha, iu ka ndërprerë kontrata dhe ajo kompani nuk ka asgjë më me Komunën e Rahovecit. Kush është fajtori? Të gjithë janë nga pak fajtorë. Unë vetë kam qenë aty dhe personalisht nuk më është dukur që është diçka në rregull, por, kur e kam pyetur mbikëqyrjen, më ka thënë që "mirë është duke shkuar" dhe pas 2-3 dite doli që nuk është mirë. Do ta përfundojmë punën si duhet, në këtë rrugë mjaft të rëndësishme dhe mjaft të qarkullueshme. Meqë jemi në këtë pikë, po ju jap një njoftim: Ne e kemi fituar "Grantin e Performancës" për vitin 2024 dhe jemi komuna e parë. Granti është mbi 2.1 milionë dhe nëse ka edhe bonus, mund të rritet vlera. Me këtë, ne e kemi mundësinë dhe do të provoj që ta ndaj një pjesë të Grantit të Performancës për përmbylljen e punimeve të sheshit qendror. Sivjet, në vjeshtën e vonë, do të provojmë t'i përfundojmë punimet në shesh, gjithmonë nëse nuk ka situata emergjente.

Bujar Mustafa: I kam dy pyetje për ekzekutivin: Kur do të filloni me rinovimin dhe rregullimin e tualeteve nëpër shkolla, sepse në disa shkolla ka probleme të mëdha, sidomos në dy shkolla në fshatin Celinë? - Pyetja e dytë: Kur do të filloni me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pikave grumbulluese të mbeturinave inerte, sidomos nevojë urgjente është në fshatin Celinë. Është bërë e pamundur që qytetarët t'i hedhin mbeturinat në gropën e caktuar dhe ajo pikë grumbulluese veç një herë është pastruar nga komuna dhe 2-3 herë prej kompanive private në bazë vullnetare.

Enis Durguti: Po ndërlidhem te rruga "Gëzim Hamza" pasi ishte çështja aty. Sa më kujtohet, kjo rrugë ka pasur vonesa të shumta, diku në verën e vitit 2024 ishte e gropuar ashtu dhe në vete ka qenë një telenovelë goxha e gjatë, duke i bllokuar qytetarët dhe bizneset. Tutje, gropimi i K.R.U. "Gjakovë", apo kushdo që ka punuar, ka pasur probleme teknike, sepse ka qenë shumë cekët pjesa e ujësjellësit, gjë që tani qytetarët kanë probleme me ujë, dimrit e verës. Verës ujë të nxehtë, ndërsa dimrit ngrirje të ujit. Kryetari ma përkujtoi kur tha "do të ketë ndërhyrje përsëri". Me një dokumentar të "Kallxo.com"-it, drejtori i Shërbimeve Publike e kishte cekur që kjo është punë e përkohshme dhe do të kemi ndërhyrje përsëri. Pse bëhet një punë 2-3 herë? Pse nuk bëhet një planifikim pak më i mirë me të gjithë aktorët (K.R.U. "Gjakova", Ekoregjioni, Kedsj etj.). A është kjo sa për t'i hapur tenderët (kontratat), apo është bërë gabim i hapave në rrugën "Gëzim Hamza"?

Kryetari: E para, ajo rrugë ka zgjatur edhe për shkak të asaj që K.R.U. "Gjakova" nuk ka planifikuar dhe në këtë rast ne nuk jemi fajtorë. Ne provojmë të merremi vesh me ta, ndërsa ata nuk kanë plan. Këtu ka zgjatur procesi, por nuk është telenovelë. E dyta, nëse K.R.U. "Gjakova" lidh kontratë me një operator, tani ajo është përgjegjëse se sa duhet të jenë thellë gypat. Është e vërtetë që ka pasur vërejtje dhe po ashtu është bërë ndërhyrje, por gjithashtu është e vërtetë që kompetente për këto është K.R.U. "Gjakova", jo komuna. Do të kemi kohë që t'i qartësojmë gjërat dhe t'i mësojmë se kush e çka është. Ndërsa për punët e komunës, përgjigjet autoriteti kontraktues. Normalisht që ne nuk hapim punë që veç sa ta shpallim një procedurë të prokurimit dhe nuk është as ideja e as dëshira, por ndonjëherë në proces mund të ndodhin veprime të paparashikuara. Mund të ketë situatë: Ndonjë kërkesë nga bizneset për bartjen e ujërave të zeza, sepse dikush do të investojë në një qendër tregtare dhe më pas duhet të hyjmë përsëri nëpër rrugën "Gëzim Hamza", ta fusim gypin thellë, në mënyrë që të derdhet më poshtë dhe problem me ujëra të zeza të mos ketë ajo qendër tregtare që potencialisht mund të bëhet, përballë palestrës sportive të sheshi qendror. Me këtë ndërhyrje, ne synojmë ta bëjmë një rrugë të qëndrueshme dhe cilësore. Do të provojmë që edhe KEDS-i t'i heqë të gjitha shtyllat elektrike dhe t'i vendosë nën tokë. Qëllimi ynë është që rrugët të jenë me standarde të larta. Në rastin e rrugës "Gëzim Hamza", peshën e përgjegjësisë e ka K.R.U. "Gjakova", sepse për punime ka kontraktuar nënkontraktor. Sa i përket asaj që e tha Bujari: Ne kemi kontratë për rinovime në shkollë dhe ju mund ta pyesni drejtorin e shkollës se çka ka ndodhur me objektin e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët "Faik Konica" në Celinë, a ka pasur program të eficiencës të energjisë, a ka pasur ndërhyrje të nyjave sanitare, a ka pasur termoizolim, si dhe a ka nevojë përsëri për ndërhyrje? Po, gjithsesi. Pra, normalisht që kërkohet përkushtim dhe përgjegjësi edhe të drejtorëve të shkollave, si dhe të këshillave drejtues. Shpesh ka edhe dëmtime të nyjave sanitare, por në shumicën e shkollave kemi veprime të vazhdueshme, qoftë me fond të eficiencës së energjisë, qoftë me rinovim. Krejt çka na mbetet është të kujdesemi që, numri i nxënësve të mos ulet dhe t'i ruajmë vendet e punës për mësimdhënësit që janë duke punuar. Sa iu përket deponive: Kanë qenë disa keqkuptime, por ne vetëm një vend të certifikuar e kemi për mbeturina inerte, vendi të rruga për Drenoc. Kemi pasur vështirësi për mirëmbajtje, sepse deponia nuk ka pasur mirëmbajtje, tani e ka. E di se ku është ai vend në Celinë dhe do të provojmë ta certifikojmë, jo vetëm në Celinë, por në të gjitha vendet ku ka nevojë dhe tutje inspektorët t'i angazhojmë në punë.

Besnik Hoti: Faleminderit, kryesues! Kryetar, e kam një kërkesë sa i përket çështjes së rrugëve. Në rrugën Xërxë-Kramovik është gjendja shumë e keqe. Personalisht e di që nuk është kompetencë e komunës, por është mirë ta shfrytëzosh autoritetin tënd në ministri, sepse gjendja është jo e mirë, sidomos në mes të fshatit Ratkoc dhe Dejnë. Në atë zonë rruga ka rrëshqitur mjaft dhe do të ishte mirë të rregullohet, gjë që mund t'i evitojmë edhe aksidentet.

Kryetari: Për momentin kemi qeveri në detyrë dhe nëse mbetet ministri në detyrë ministër ose zv. ministër, atëherë është mirë, sepse kemi krijuar relacione të punës. Kemi premtim dhe shpresojmë që sivjet do të kontraktohet kompania për rrugën Gradish – Kramovik, ndërsa është pak e çuditshme që pse ende nuk e kanë shpallur procedurën. Gjithashtu, shpresoj që do të kemi edhe zgjerim të rrugës rajonale Prizren – Xërxë – Gjakovë, sepse janë bërë disa matje dhe fjalët janë të mira. Po presim të miratohet buxheti dhe besoj që do të marrin epilog disa rrugë në komunë.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! A ka edhe dikush tjetër edhe ndonjë pyetje? Nëse jo, atëherë në zyrën e kryesuesit, po ashtu edhe të kryetarit, ka arritur një kërkesë nga Kompania Regjionale për Mbeturina "Ekoregjioni" me seli në Prizren, përkatësisht nga kryeshefi, Burim Shala. Kërkesa ka të bëjë me ngritjen e tarifës për shërbimet e mbeturinave. Kështu që, ne do ta diskutojmë bashkërisht dhe do ta shohim mundësinë nëse do ta kemi si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e radhës. E dyta, ju kërkoj falje që pauzën nuk e shfrytëzuam fare. Shihemi në seancën e radhës.

Procesmbajtësi:

Albjon Krasniqi



